



Republika e Kosovës
Republika Kosovo - Republic of Kosovo
Kuvendi - Skupština – Assembly

Legjislatura VI
Sesioni pranveror

Kuvendi i Republikës së Kosovës, në mbështetje të nenit 65 (1) të Kushtetutës së Republikës së Kosovës dhe nenit 52, paragrafi 2 i Rregullores së Kuvendit, pas debatit të zhvilluar në seancën plenare, të mbajtur më 19 dhe 28 qershor 2018, me propozimin e Grupi Parlamentar të Lidhjes Demokratike të Kosovës, miratoi këtë:

REZOLUTË

1. Në afat prej dy javësh, Qeveria të sjellë në Kuvend Programin Kombëtar (të rishikuar) për Zbatimin e MSA-së për vitin 2018, i cili plan merr parasysh vonesat e deritashme.
2. Komisioni Parlamentar për MSA dhe Komisioni për Integritim Evropian ta shqyrtojë në afat prej dy javësh këtë program me zyrarët përkatës të Qeverisë dhe t'i paraqesin Kuvendit raport me shkrim, duke identifikuar masat prioritare dhe institucionet përgjegjëse.
3. Pas çdo tremujori, Komisioni Parlamentar për MSA t'i paraqesë Kuvendit raport me shkrim lidhur me realizimin e Programit Kombëtar për Zbatimin e MSA-së.
4. Të gjitha komisionet parlamentare obligohen ta përcjellin punën e dikastereve qeveritare dhe të institucioneve të tjera, të cilat ato i mbulojnë lidhur me detyrat e tyre të parapara në Programin Kombëtar për Zbatimin e MSA-së.
5. Në afat prej dy javësh, Kuvendi ta bëjë një plan veprimi për përsheptimin e projektligjeve që lidhen me Agjendën e Reformave Evropiane dhe MSA-në dhe presin për miratim.

Nr. 06-R- 11
Prishtinë, 28.06.2018

Kryetari i Kuvendit
Kadri VESELI

Rezoluta u dërgohet:

- Qeverisë së Republikës së Kosovës,
- Grupeve parlamentare dhe
- Arkivit të Kuvendit.